



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.53/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj dhe anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Qëndrim Kryeziu kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, lidhur me rinumërimin e fletëvotimeve në QNR, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datë 7 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me 22.06.2026, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.53/2026, e datës 20.06.2026, e parashtruar nga Qëndrim Kryeziu, kandidat për deputet, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, lidhur me rinumërimin e fletëvotimeve në QNR, të kandidatëve për deputet të subjektit politik PDK, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datë 7 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Me datën 20.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën, ZP.Anr.53/2026, të parashtruar nga Qëndrim Kryeziu, kandidat për deputet, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas përfundimit të procesit të numërimit të votave të kandidatëve në Qendrat Komunale të Numërimit, ka konstatuar mospërputhje të evidentuara gjatë procesit të numërimit dhe për këtë arsye ka urdhëruar rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta. Sipas ankuesit, vetë fakti se janë konstatuar gabime në këto vendvotime dëshmon se numërimi fillestar nuk ka qenë plotësisht i saktë dhe krijon dyshim objektiv se pasaktësi të ngjashme mund të ekzistojnë edhe në vendvotime të tjera që nuk janë përfshirë në rinumërim. Ankuesi thekson se pas rinumërimit të 185 vendvotimeve janë evidentuar ndryshime në numrin e votave preferenciale të kandidatëve, përfshirë edhe 589 vota shtesë në favor të tij. Sipas tij, duke pasur parasysh rëndësinë e çdo vote në përcaktimin e renditjes së kandidatëve dhe ndarjen e mandateve, ekziston nevoja që të verifikohet në tërësi saktësia e numërimit të votave preferenciale të kandidatëve të subjektit politik PDK. Ankuesi konsideron se

integriteti i procesit zgjedhor, parimi i sigurisë juridike, e drejta për zgjedhje të lira dhe demokratike, si dhe nevoja për garantimin e vullnetit të zgjedhësve imponojnë rinumërimin e plotë të votave preferenciale të kandidatëve të subjektit politik PDK. Pala ankuese kërkon që të aprovohet si e bazuar ankesa e ankuesit z. Qëndrim Kryeziu, kandidat për deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës, me numër rendor 103, të Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe të zhvillojë rinumërimin e plotë të gjitha fletëvotimeve të vlefshme të Partisë Demokratike të Kosovës për kandidatët për deputet nga të gjitha vendvotimet që nuk janë përfshirë në rinumërimin e urdhëruar me Vendimin nr. 01/1300/2026.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përgjigjen e paraqitur pranë Panelit, ka kërkuar refuzimin e ankesës si të pabazuar. KQZ ka sqaruar se procesi i verifikimit të votave të subjekteve politike dhe numërimit të votave preferenciale të kandidatëve është zhvilluar në të gjitha Qendrat Komunale të Numërimit në përputhje me legjislacionin zgjedhor dhe aktet nënligjore në fuqi. KQZ ka theksuar se rinumërimi i 185 vendvotimeve nuk është urdhëruar si rezultat i konstatimit të parregullsive sistematike në procesin e numërimit, por në bazë të mekanizmit kontrollues të paraparë me Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 02/2026 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore Nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Sipas KQZ-së, me vendimin e datës 17.06.2026 është miratuar rekomandimi për rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta, përkatësisht 7.41% e gjithsej 2,498 vendvotimeve të rregullta, me qëllim verifikimin e saktësisë së procesit të numërimit. KQZ ka theksuar se rezultatet e rinumërimit nuk kanë evidentuar ekzistimin e ndonjë modeli sistematik të pasaktësive, pasi ndryshimet janë evidentuar në të dy drejtimet, ku një numër kandidatësh kanë fituar vota ndërsa kandidatë të tjerë kanë humbur vota. Gjithashtu, ankuesi nuk ka identifikuar asnjë vendvotim konkret, qendër votimi apo qendër numërimi jashtë mostrës së rinumëruar dhe nuk ka paraqitur prova konkrete që do të mbështesnin pretendimin se pasaktësi të ngjashme ekzistojnë edhe në vendvotimet e tjera. Për këto arsye, KQZ konsideron se nuk ekziston bazë faktike dhe juridike për urdhërimin e rinumërimit të plotë të votave preferenciale të kandidatëve të subjektit politik PDK. Në përgjigje në ankesë kërkohet që të hedhë poshtë ankesën, si të paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 105 të Ligjit Nr. 08/L-228, të konstatojë se ankuesi nuk ka paraqitur pretendime konkrete dhe prova të mjaftueshme për parregullsi në vendvotimet që nuk janë përfshirë në rinumërim.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

-Ankesa është e pa bazuar.

Pas shqyrtimit të ankesës, përgjigjes në ankesë dhe provave të administruara në shkresat e lëndës, Paneli gjen se ankesa është e pabazuar.

Paneli fillimisht konstaton se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e lejuar dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit të parapare ligjor, pasi që rinumërimi ka përfunduar me dt.19.06.2026, në ora 12 kështu që ankesa është paraqitur me dt. 20.06.2026.

Paneli gjen se me vendimin e datës 17.06.2026, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke vepruar në bazë të neneve 63, 64 paragrafi 2.1 dhe 65 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 02/2026 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore Nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, ka miratuar rekomandimin për rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta, përkatësisht 7.41% të gjithsej 2,498 vendvotimeve të rregullta.

Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se rinumërimi është urdhëruar si pjesë e një mekanizmi kontrollues të paraparë me legjislacionin zgjedhor, me qëllim verifikimin e saktësisë së procesit të numërimit dhe jo si rezultat i konstatimit paraprak të parregullsive sistematike në procesin e administrimit dhe numërimit të votave.

Paneli vlerëson se qëllimi i mekanizmit të paraparë me nenin 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 02/2026 është pikërisht verifikimi përmes një mostre përfaqësuese i saktësisë së procesit të numërimit dhe vlerësimi nëse rezultatet e kontrollit krijojnë nevojë për ndërmarrjen e masave shtesë të verifikimit. Vetë aktivizimi i këtij mekanizmi nuk krijon prezumim juridik se procesi i numërimit në tërësi ka qene i pasaktë dhe as nuk mund te nënkuptohet me automatizëm si domosdoshmëri për zgjerimin e rinumërimit.

Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton se pas rinumërimit të 185 vendvotimeve janë evidentuar ndryshime në rezultatet e kandidatëve në të dy drejtimet, ku një numër kandidatësh minimalisht kanë fituar vota ndërsa kandidatë të tjerë po ashtu ne mënyrë minimale kanë humbur disa vota.

Sipas të dhënave zyrtare të krahasimit ndërmjet numërimit në QKN dhe rinumërimit në QNR, votat e kandidatit me numër 103, Qëndrim Kryeziu, kanë ndryshuar vetëm në dy vendvotime. Në total, kandidati ka dy (2) vota më pak pas rinumërimit, dhe jo 589 vota më shumë. Pretendimi për 589 vota nuk përputhet me të dhënat zyrtare të publikuara nga KQZ.

Këto ndryshime nuk janë pasqyrim i një modeli të përgjithshëm ose sistematik të pasaktësive, por dëshmojnë se korrigjimet e evidentuara kanë qenë të shpërndara dhe nuk kanë prodhuar efekt të tillë që do të vinte në dyshim integritetin e përgjithshëm të procesit të numërimit.

Paneli konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit ishin të përgjithësuara, megjithëse i është referuar për parregullsi të supozuara në QKN, ai nuk ka identifikuar asnjë vendvotim konkret, qendër votimi, qendër komunale të numërimit apo tavolinë numërimi jashtë mostrës së rinumëruar, për të cilat mund te vihet ne dyshim se ka pasur parregullsi. Po ashtu, ankuesi nuk ka paraqitur formularë rezultatesh, raporte të vëzhguesve, kundërshtime të paraqitura gjatë procesit të numërimit apo prova të tjera konkrete që do të mbështesnin pretendimin lidhur me pasaktësitë e evidentuara në mostrën e kontrolluar apo nëse pasaktësitë e tilla mund te jene përsëritur edhe në vendvotimet e tjera. Për rrjedhojë, pretendimi i ankuesit se mund të ekzistojnë gabime edhe në vendvotimet e tjera mbetet në nivel të supozimit dhe nuk mbështetet në prova konkrete.

Paneli vlerëson se procedurat e procesit zgjedhor përfshirë edhe procesin e numërimit si dhe atë te rinumërimit bazohen në parimin e ligjshmërisë dhe sigurisë juridike. Për rrjedhojë, një masë e jashtëzakonshme siç është rinumërimi i plotë i votave preferenciale të kandidatëve të një subjekti politik në nivel vendi nuk mund të urdhërohet vetëm mbi bazën e pretendimeve hipotetike ose dyshimeve abstrakte, por vetëm atëherë kur realisht ekzistojnë fakte dhe prova

objektive që tregojnë se rezultati zgjedhor mund të jetë cenuar seriozisht nga parregullsia të evidentuara ose të përhapura në mënyrë sistematike.

Sa i përket pretendimit të ankuesit lidhur me diferencë votash ndërmjet tij dhe kandidatëve të renditur para tij, Paneli konsideron se ndonëse kjo rrethanë mund të jetë relevante për interesin individual të ankuesit, por ajo nuk mund të zëvendësojë kërkesën ligjore për paraqitjen e provave konkrete që do të justifikonin urdhërimin e rinumërimit të përgjithshëm.

Prandaj, Paneli arrin në përfundimin se ankuesi nuk ka arritur të provojë ekzistimin e rrethanave faktike dhe juridike që do të arsyetonin kalimin nga mekanizmi kontrollues i rinumërimit të mostrës së vendvotimeve në rinumërimin e plotë të votave preferenciale të kandidatëve të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *"PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht"* dhe Nenit 13 par. 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin në mënyrë decisive thuhet se: *"PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë"*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli ka vlerësuar se ankesa e paraqitur nga kandidati për deputet të Kuvendit Kosovës Qëndrim Kryeziu, është e pabazuar, pasi që pretendimet e paraqitura në ankesë mbeten në nivel deklarativ dhe nuk mbështeten në prova materiale që do të mundësonin konstatimin e një shkeljeje zgjedhore. Vetë pretendimi për manipulim apo tjetërsim të vullnetit të votuesve nuk mund të merret si bazë për aprovimin e ankesës pa prova konkrete dhe të verifikueshme. Për rrjedhojë, në mungesë të provave konkrete, duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së në të cilin nen në mënyrë decisive se: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar në nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, si dhe nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.53/2026 më datën 22.06.2026

Kryesues i Panelit,
Skender Çoçaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.28/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Franciska Zhitija Ymeri dhe Milena Djeric, anëtarë, lidhur me ankesën e kandidatit për deputet Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të refuzimit të ankesës lidhur me rinumërimin e fletëvotimeve në QNR, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 Qershor 2026, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.53/2026, të datës 22.06.2026, në seancën e mbajtur me datë, 25.06.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e kandidatit për deputet Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, (PZAP), ZP.Anr.53/2026, të datës 22.06.2026.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZP.Anr.53/2026, të datës 22.06.2026, është vendosur: "REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.53/2026, e datës 20.06.2026, e parashtruar nga Qëndrim Kryeziu, kandidat për deputet, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, lidhur me rinumërimin e fletëvotimeve në QNR, të kandidatëve për deputet të subjektit politik PDK, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datë 7 Qershor 2026".

Kundër vendimit të lartpërmendur, kandidati për deputet Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën pretendon se vendimi i PZAP-së është i gabuar dhe si i tillë duhet anuluar, sepse është i bazuar në një vlerësim të ngushtë dhe formalist të provave, pa analizuar peshën juridike të faktit se ndryshime në vota janë konstatuar te 90 nga 110 kandidatët e PDK-së, dhe pa dhënë arsye të mjaftueshme pse 96.48% e votave të PDK-së mund të mbeten pa verifikim pas konstatimit të mospërputhjeve në pjesën e rinumëruar. Pastaj ka pretenduar se vetëm rinumërimi i fletëvotimeve të vlefshme të PDK-së, duke përjashtuar ato tashmë të rinumëruara, mund të parantojë që rezultati përfundimtar të pasqyrojë saktë vullnetin e votuesve dhe që çdo kandidat të ketë të evidentuara saktësisht votat

e fituara, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë ankesën si të bazuar, të anulohet vendimin e PZAP, ZP.Anr.53/2026, të datës 22.06.2026, dhe të urdhërojë KQZ-në që të rinumëroj në QNR, të gjitha fletëvotimet e vlefshme të PDK-së, përkatësisht votat preferenciale të kandidatëve të PDK-së, duke përjashtuar ato tashmë të rinumëruara sipas vendimit të KQZ-së.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të kandidatit për deputet Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e kandidatit për deputet Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZP.Anr.53/2026, i datës 22.06.2026.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 20.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën, ZP.Anr.53/2026, të parashtruar nga Qëndrim Kryeziu, kandidat për deputet, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas përfundimit të procesit të numërimit të votave të kandidatëve në Qendrat Komunale të Numërimit, ka konstatuar mospërputhje të evidentuara gjatë procesit të numërimit dhe për këtë arsye ka urdhëruar rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta. Sipas ankuesit, vetë fakti se janë konstatuar gabime në këto vendvotime dëshmon se numërimi fillestar nuk ka qenë plotësisht i saktë dhe krijon dyshim objektiv se pasaktësi të ngjashme mund të ekzistojnë edhe në vendvotime të tjera që nuk janë përfshirë në rinumërim. Ankuesi thekson se pas rinumërimit të 185 vendvotimeve janë evidentuar ndryshime në numrin e votave preferenciale të kandidatëve, përfshirë edhe 589 vota shtesë në favor të tij. Sipas tij, duke pasur parasysh rëndësinë e çdo vote në përcaktimin e renditjes së kandidatëve dhe ndarjen e mandateve, ekziston nevoja që të verifikohet në tërësi saktësia e numërimit të votave preferenciale të kandidatëve të subjektit politik PDK. Po ashtu ankuesi konsideron se integriteti i procesit zgjedhor, parimi i sigurisë juridike, e drejta për zgjedhje të lira dhe demokratike, si dhe nevoja për garantimin e vullnetit të zgjedhësve imponojnë rinumërimin e plotë të votave preferenciale të kandidatëve të subjektit politik PDK. Pala ankuese kërkon që të aprovet si e bazuar ankesa e ankuesit z. Qëndrim Kryeziu, kandidat për deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës, me numër rendor 103, të Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe të zhvillojë rinumërimin e plotë të gjitha fletëvotimeve të vlefshme të Partisë Demokratike të Kosovës për kandidatët për deputet nga të gjitha vendvotimet nuk janë përfshirë në rinumërimin e urdhëruar me Vendimin nr. 01/1300/2026.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror Zgjedhor ka kërkuar refuzimin e ankesës si të pabazuar, me pretendim se KQZ ka sqaruar se procesi i verifikimit të votave të subjekteve politike dhe numërimit të votave preferenciale të kandidatëve është zhvilluar në të gjitha

Qendrat Komunale të Numërimit në përputhje me legjislacionin zgjedhor dhe aktet nënligjore në fuqi. KQZ ka theksuar se rinumërimi i 185 vendvotimeve nuk është urdhëruar si rezultat i konstatimit të parregullsive sistematike në procesin e numërimit, por në bazë të mekanizmit kontrollues të paraparë me Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 02/2026 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore Nr.14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Sipas KQZ-së, me vendimin e datës 17.06.2026 është miratuar rekomandimi për rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta, përkatësisht 7,41% e gjithsej 2,498 vendvotimeve të rregullta, me qëllim verifikimin e saktësisë së procesit të numërimit. KQZ ka theksuar se rezultatet e rinumërimit nuk kanë evidentuar ekzistimin e ndonjë modeli sistematik të pasaktësive, pasi ndryshimet janë evidentuar në të dy drejtimet, ku një numër kandidatësh kanë fituar vota ndërsa kandidatë të tjerë kanë humbur vota. Gjithashtu, ankuesi nuk ka identifikuar asnjë vendvotim konkret, qendër votimi apo qendër numërimi jashtë mostrës së rinumëruar dhe nuk ka paraqitur prova konkrete që do të mbështesnin pretendimin se pasaktësi të ngjashme ekzistojnë edhe në vendvotimet e tjera. Për këto arsye, KQZ konsideron se nuk ekziston bazë faktike dhe juridike për urdhërimin e rinumërimit të plotë të votave preferenciale të kandidatëve të subjektit politik PDK. Në përgjigje në ankesë kërkohet që të hedhë poshtë ankesën, si të paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 105 të Ligjit Nr. 08/L-228, të konstatojë se ankuesi nuk ka paraqitur pretendime konkrete dhe prova të mjaftueshme për parregullsi në vendvotimet që nuk janë përfshirë në rinumërim.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se e njëjta është e pabazuar. Paneli fillimisht konstaton se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e lejuar dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit të parapare ligjor, pasi që rinumërimi ka përfunduar me datë 19.06.2026, në ora 12, kështu që ankesa është paraqitur me datë 20.06.2026. Paneli gjen se me vendimin e datës 17.06.2026, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke vepruar në bazë të neneve 63, 64 paragrafi 2.1 dhe 65 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 02/2026 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore Nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, ka miratuar rekomandimin për rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta, përkatësisht 7.41 % të gjithsej 2,498 vendvotimeve të rregullta. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se rinumërimi është urdhëruar si pjesë e një mekanizmi kontrollues të paraparë me legjislacionin zgjedhor, me qëllim verifikimin e saktësisë së procesit të numërimit dhe jo si rezultat i konstatimit paraprak të parregullsive sistematike në procesin e administrimit dhe numërimit të votave.

Paneli më tej ka vlerësuar se qëllimi i mekanizmit të paraparë me nenin 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 02/2026 është pikërisht verifikimi përmes një mostre përfaqësuese i saktësisë së procesit të numërimit dhe vlerësimi nëse rezultatet e kontrollit krijojnë nevojë për ndërmarrjen e masave shtesë të verifikimit. Vetë-aktivizimi i këtij mekanizmi nuk krijon prezumim juridik se procesi i numërimit në tërësi ka qenë i pasaktë dhe as nuk mund të nënkuptohet me automatizim si domosdoshmëri për zgjerimin e rinumërimit. Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton se pas rinumërimit të 185 vendvotimeve janë evidentuar ndryshime në rezultatet e kandidatëve në të dy drejtimet, ku një numër kandidatësh minimalisht kanë fituar

vota ndërsa kandidatë të tjerë po ashtu në mënyrë minimale kanë humbur disa vota. Sipas të dhënave zyrtare të krahasimit ndërmjet numërimit në QKN dhe rinumërimit në QNR, votat e kandidatit me numër 103, Qëndrim Kryeziu, kanë ndryshuar vetëm në dy vendvotime. Në total, kandidati ka dy (2) vota më pak pas rinumërimit, dhe jo 589 vota më shumë. Pretendimi për 589 vota nuk përputhet me të dhënat zyrtare të publikuara nga KQZ. Këto ndryshime nuk janë pasqyrim i një modeli të përgjithshëm ose sistematik të pasaktësive, por dëshmojnë se korrigjimet e evidentuara kanë qenë të shpërndara dhe nuk kanë prodhuar efekt të tillë që do të vinte në dyshim integritetin e përgjithshëm të procesit të numërimit.

Paneli tutje ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit ishin të përgjithësuara, megjithëse i është referuar për parregullsi të supozuara në QKN, ai nuk ka identifikuar asnjë vendvotim konkret, qendër votimi, qendër komunale të numërimit apo tavolinë numërimi jashtë mostrës së rinumëruar për të cilat mund të vihet në dyshim se ka pasur parregullsi. Po ashtu, ankuesi nuk ka paraqitur formularë rezultatesh, raporte të vëzhguesve, kundërshtime të paraqitura gjatë procesit të numërimit apo prova të tjera konkrete që do të mbështesnin pretendimin lidhur me pasaktësitë e evidentuara në mostrën e kontrolluar apo nëse pasaktësitë e tilla mund të jenë përsëritur edhe në vendvotimet e tjera. Për rrjedhojë, pretendimi i ankuesit se mund të ekzistojnë gabime edhe në vendvotimet e tjera mbetet në nivel të supozimit dhe nuk mbështetet në prova konkrete. Paneli vlerëson se procedurat e procesit zgjedhor përfshirë edhe procesin e numërimit si dhe atë të rinumërimit bazohen në parimin e ligjshmërisë dhe sigurisë juridike. Për rrjedhojë, një masë e jashtëzakonshme siç është rinumërimi i plotë i votave preferenciale të kandidatëve të një subjekti politik në nivel vendi nuk mund të urdhërohet vetëm mbi bazën e pretendimeve hipotetike ose dyshimeve abstrakte, por vetëm atëherë kur realisht ekzistojnë fakte dhe prova objektive që tregojnë se rezultati zgjedhor mund të jetë cenuar seriozisht nga parregullsi të evidentuara ose të përhapura në mënyrë sistematike. Ndërsa sa i përket pretendimit të ankuesit lidhur me diferencë votash ndërmjet tij dhe kandidatëve të renditur para tij, Paneli konsideron se ndonëse kjo rrethanë mund të jetë relevante për interesin individual të ankuesit, por ajo nuk mund të zëvendësojë kërkesën ligjore për paraqitjen e provave konkrete që do të justifikonin urdhërimin e rinumërimit të përgjithshëm. Prandaj, Paneli arrin në përfundimin se ankuesi nuk ka arritur të provojë ekzistimin e rrethanave faktike dhe juridike që do të arsyetonin kalimin nga mekanizmi kontrollues i rinumërimit të mostrës së vendvotimeve në rinumërimin e plotë të votave preferenciale të kandidatëve të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *"PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht"* dhe Nenit 13 par. 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin në mënyrë decisive thuhet se: *"PZAP-i mund të përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë"*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli ka vlerësuar se ankesa e paraqitur nga kandidati për deputet të Kuvendit Kosovës Qëndrim Kryeziu, është e pabazuar, pasi që pretendimet e paraqitura në ankesë mbeten në nivel deklarativ dhe nuk mbështeten në prova materiale që do të mundësonin

konstatimin e një shkeljeje zgjedhore. Vetë pretendimi për manipulim apo tjetërsim të vullnetit të votuesve nuk mund të merret si bazë për aprovimin e ankesës pa prova konkrete dhe të verifikueshme. Për rrjedhojë, në mungesë të provave konkrete, duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me refuzimin e ankesës së kandidatit për deputet Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të refuzimit të ankesës lidhur me rinumërimin e fletëvotimeve në QNR, të kandidatëve për deputet të subjektit politik PDK, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datë 7 Qershor 2026. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se shkeljet e pretenduara në ankesë se PZAP në vendimin e saj është bazuar në një vlerësim të ngushtë dhe formalist të provave, pa analizuar peshën juridike të faktit se ndryshime në vota janë konstatuar te 90 nga 110 kandidatët e PDK-së, dhe pa dhënë arsye të mjaftueshme pse 96.48% e votave të PDK-së mund të mbeten pa verifikim pas konstatimit të mospërputhjeve në pjesën e rinumëruar, nga kolegji i Gjykatës Supreme vlerësohen të pabazuara.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të kandidatit për deputet Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, lidhur me atë se vetëm rinumërimi i fletëvotimeve të vlefshme të PDK-së, duke përjashtuar ato tashmë të rinumëruara, mund të garantojë që rezultati përfundimtar të pasqyrojë saktë vullnetin e votuesve dhe që çdo kandidat të ketë të evidentuara saktësisht votat e fituara, ndërsa vendimi i PZAP e trajton kërkesën për rinumërim si pretendim abstrakt, duke rezultuar kështu në gabime themelore të këtij vendimi, mirëpo këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme. Kjo për faktin se PZAP, me rastin e refuzimit të ankesës së ankuesit, si në vendimin e atakuar, me të drejtë ka vlerësuar se kërkesa e kandidatit për deputet Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është e pabazuar. Në lidhje me këtë, nga shkresat e lëndës rezulton se, pas rinumërimit të 185 vendvotimeve janë evidentuar ndryshime në rezultatet e kandidatëve në të dy drejtimet, ku një numër kandidatësh minimalisht kanë fituar vota, ndërsa kandidatë të tjerë po ashtu në mënyrë minimale kanë humbur disa vota. Sipas të dhënave zyrtare të krahasimit ndërmjet numërimit në QKN dhe rinumërimit në QNR, votat e kandidatit me numër 103, Qëndrim Kryeziu, kanë ndryshuar vetëm në dy vendvotime. Në total, kandidati ka dy (2) vota më pak pas rinumërimit, dhe jo 589 vota më shumë, dhe se pretendimi për 589 vota nuk përputhet me të dhënat zyrtare të publikuara nga KQZ. Për më tepër këto ndryshime nuk janë pasqyrim i një modeli të përgjithshëm ose sistematik të pasaktësive, por dëshmojnë se korrigjimet e evidentuara kanë qenë të shpërndara

dhe nuk kanë prodhuar efekt të tillë që do të vinte në dyshim integritetin e përgjithshëm të procesit të numërimit.

Nga këto të dhëna, me të drejtë PZAP ka konstatuar se pretendimet e palës ankuese, ishin të përgjithësuara, pasi që megjithëse ankuesi është referuar për parregullsi të supozuara në QKN, ai nuk ka identifikuar asnjë vendvotim konkret, qendër votimi, qendër komunale të numërimit apo tavolinë numërimi jashtë mostrës së rinumëruar për të cilat mund të vihet në dyshim se ka pasur parregullsi. Po ashtu, ankuesi nuk ka paraqitur formularë rezultatesh, raporte të vëzhguesve, kundërshtime të paraqitura gjatë procesit të numërimit apo prova të tjera konkrete që do të mbështesnin pretendimin lidhur me pasaktësitë e evidentuara në mostrën e kontrolluar apo nëse pasaktësitë e tilla mund të jenë përsëritur edhe në vendvotimet e tjera. Për rrjedhojë, pretendimi i ankuesit se mund të ekzistojnë gabime edhe në vendvotimet e tjera mbetet në nivel të supozimit dhe nuk mbështetet në prova konkrete. Si rrjedhojë e të cekurave më lartë, edhe për kolegjin e Gjykatës Supreme është i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP-së se parashtruesi i ankesës nuk ka mbështetje të pretendimeve të tij lidhur me parregullsi në QKN, për çka edhe me të drejtë një ankesë e tillë është refuzuar si e pabazuar.

Në anën tjetër kolegji i Gjykatës Supreme, ka vlerësuar edhe pretendimet ankimore të ankuesit që kanë të bëjnë atë se vendimi i PZAP-së është i ngushtë dhe formalist duke kërkuar që të bëhet rinumërimi në QNR i të gjitha fletëvotimeve të vlefshme të PDK-së, përkatësisht votave preferenciale të PDK-së, me përjashtim të atyre të rinumëruara, mirëpo të njëjtat pretendime janë vlerësuar të pabazuara. Kjo pasi që PZAP me vendimin e tij ka sqaruar se procesi i verifikimit të votave të subjekteve politike dhe numërimit të votave preferenciale është zhvilluar në përputhje me legjislacionin zgjedhor në fuqi. Edhe sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme rezulton se rinumërimi i 185 vendvotimeve është urdhëruar nga KQZ-ja në kuadër të mekanizmit kontrollues të paraparë me ligj, me qëllim verifikimin e saktësisë së procesit të numërimit, dhe jo si pasojë e konstatimit të parregullsive sistematike në administrimin apo numërimin e votave. Për më tepër nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi nuk ka ofruar prova konkrete dhe të verifikueshme që do të mbështesnin pretendimet e tij për ekzistimin e parregullsive në procesin e numërimit, respektivisht i njëjti nuk ka identifikuar vendvotime specifike, nuk ka paraqitur dokumentacion zgjedhor relevant apo ndonjë provë tjetër materiale nga e cila do të mund të konstatohet se gabimet e evidentuara në mostrën e rinumëruar janë përsëritur edhe në vendvotime të tjera. Andaj, pretendimet e ankuesit në ankesë lidhur me mundësinë e ekzistimit të pasaktësive në vendvotime të tjera sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme janë të paqëndrueshme, pasi që të njëjtat mbesin në nivel supozimesh dhe të pambështetura në prova konkrete, dhe si të tilla nuk mund të shërbejnë si bazë juridike për rinumërimin e përgjithshëm të votave.

Si rrjedhojë, Gjykata Supreme vlerëson se PZAP ka vendosur drejtë lidhur me refuzimin e ankesës së ankuesit, kandidatit për deputet të Kuvendit Kosovës Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dhe atë duke iu referuar dispozitës nga neni 118.1 të LZP-së, ku është përcaktuar se: *"PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht"* dhe nenit 13 paragraf 4 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, ku është përcaktuar se: *"PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup*

ankesash nëse ato nuk paraqesin raste *prima facie* ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë". Po ashtu me nenin 117.3 të LZP-së përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*". Mbi këtë bazë kjo gjykatë i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e lartcekura se PZAP e ka refuzuar ankesën e ankuesit duke neglizhuar parimin e integritetit të procesit zgjedhor duke iu referuar mungesës së saktësisë së votave të fituara nga kandidati, kjo pasi që në rastin konkret nuk janë paraqitur dëshmi të qarta dhe bindëse për shkeljet e pretenduara, andaj edhe PZAP me të drejtë ka refuzuar ankesën si të pabazuar.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Kjo për faktin se si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakte të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.28/2026, datë 25.06.2026



Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka